



ECO-INNOVATION
WHEN BUSINESS MEETS THE ENVIRONMENT



Thirrje per Propozime 2009

CIP ECO-INNOVATION

APLIKIMET E PARA DHE PROJEKTET E RIPERTERITJES SE TREGUT

IDENTIFIKUESI I THIRRJES: CIP-ECO-INNOVATION 2009

AFATI PERFUNDIMTAR: E ENJTE 10 SHTATOR 2009

PRANOHEN VETEM APLIKIME ELEKTRONIKE, DERI NE 17:00 (ORA LOKALE
E BRUKSELIT).

PER ME SHUME INFORMACION:

<http://ec.europa.eu/ecoinnovation>

TABELE PERMBLEDHESE

1. Sfondi	3
2. Qellimi dhe objektivat e Thirrjes per Propozime 2009	5
3. Fushat prioritare te Thirrjes per propozime 2009.....	6
3.1 Riciklimi i materialeve.....	6
3.2 Ndertimet	7
3.3 Sektori i ushqimit dhe pijeve	8
3.4 Bizneset e gjelbra/ Blerjet inteligjente	9
4. Kriteret e pranueshmerise	10
4.1 Statusi ligjor i aplikanteve.....	10
5. Kriteret e perjashtimit.....	11
5.1 Arsyet per perjashtim.....	11
5.2 Penalitetet administrative dhe financiare.....	12
6. Kriteret e perzgjedhjes	13
6.1 Kapaciteti financiar i aplikanteve	13
6.2 Aftesite profesionale dhe kualifikimet	13
7. Kriteret kryesore te shpalljes se fituesit.....	14
8. KOHEZGJATJA	15
9. PERQINDJA E BASHKEFINANCIMIT KOMUNITAR.....	15
10. BUXHETI NE DISPOZICION PER KETE THIRRJE TE VITIT 2009	16
11. Periudha e pranueshmerise se kostove	16
12. KUSHTET E PERGJITHSHME PER AKORDIMIN E GRANTEVE	16
13. FORMAT E DOREZIMIT TE APLIKIMEVE PER NJE GRANT.....	17
14. INFORMACIONE SHTESE	17
15. KALENDAR INDIKATIV:	18

1. Sfondi

Iniciativa CIP¹ Eco-Innovation Aplikimet e para dhe projektet e ripërteritjes se tregut (Shkurt: CIP Eco-Innovation) eshte pjese e Programit te Siper marrjes dhe Novacionit (EIP), i cili synon te mbeshetese novacionet si dhe Nder marrjet e Vogla dhe te Mesme (SME²) ne Bashkimin European (BE). EIP ka per qellim te rrise aksesin ne financie te SME-ve, te mbeshetese sherbimet per biznesin dhe novacionin, te cilat ofrohen nepermjet nje rrjeti qendrash rajonale³, te nxise siper marrjen dhe novacionin si dhe te mbeshetese politikeberjen qe inkurajon siper marrjen dhe novacionin. Programi i punes per EIP 2009, qe perfshin CIP-Eco Innovation eshte miratur me 14 Janar 2009⁴.

EIP eshte pjese e Programit Kuader te Konkurrueshmerise dhe Novacionit (CIP), qe ka per qellim te nxise konkurrueshmerine e siper marrjeve europiane. Duke pasur SME-te si pikesynim kryesor, CIP perfshin gjithashtu nxitjen e perdorimit dhe krijimit te teknologjive te informacionit dhe komunikimit (ICT) dhe nxit rritjen e perdorimit te energjive te rinovueshme dhe eficente.

Promovimi i ECO-Inovacionit nepermjet Programit Kuader te Konkurrueshmerise dhe Novacionit (CIP) kontribuon ne zbatimin e Planit te Punes te Teknologjive Mjedisore (ETAP)⁵. Nje prej objektive kryesore te ketij Plani te Punes eshte angazhimi i potencialit maksimal te teknologjive mjedisore per mbrojtjen e mjedisit nderkohe qe kontribuon per rritjen ekonomike dhe te konkurreshmerise sipas percaktimeve te bera ne Strategjine e Lisbones⁶. CIP-Eco Innovation do te mbeshetese projekte qe lidhen me produktet, teknikat, sherbimet dhe proceset Eco-Inovative, te cilat synojne ne parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore apo kontribuojne ne perdorimin optimal te burimeve. Ne vijim, dhe ne vazhdim te zbatimit te ETAP, kjo mase synon te kontribuojte edhe ne zbatimin e aksioneve Komunitare ne fushat e Paketes se Ndryshimit te Klimes⁷ dhe te njejtjen linje me politikat e ndryshme te deklaruar Planin e Veprimit mbi Prodhimin dhe Konsumin e Qendrueshme dhe Politikes Industriale te Qendrueshme (2008)⁸. Risqet qe vijne si pasoje e ndryshimit te klimes do te kene ndikime mbi shume industri dhe sherbime, si p.sh aktivetete prodhuese te bazuara ne burime intensive dhe keto risqe kerkojne adaptim. Kjo mase duhet te kontribuojte gjithashtu per iniciativen e udheheqjes se tregut, e cila nenvijejon fusha te rendesishme veprimi si riciklimi dhe ndertimi⁹ si dhe ne zbatimin e Programi

¹ Vendimi N° 1639/2006/EC i Parlamentit European dhe i Keshillit te 24 Tetorit 2006 te cilet krijojne Programin Kuader te Konkurrueshmerise dhe Novacionit (2007 deri 2013) (CIP) (OJ L 310, 09/11/2006). Informacione mbi CIP mund te sigurohen tek: http://ec.europa.eu/cip/index_en.htm.

² Ne kete thirrje, SME-te nenkuptojne siper merrjet qe punesojne me pak se 250 persona dhe qe qarkullojne nje xhiro vjetore me te vogel se 50 milion euro, ose nje bilanc vjetor total qe nuk kalon shumen e 43 milion Eurove (Rekomandimi I Komisionit 2003/361/EC i dates 6 Maj 2003).

³ Rrjeti i Siper marrjeve European: http://www.enterprise-europe-network.ec.europa.eu/index_en.htm.

⁴ Sipas http://ec.europa.eu/cip/docs/consolidated_eip_wp_2009.pdf.

⁵ Komunikata e Komisionit mbi "Stimulimin e Teknologjive per Zhvillim te Qendrueshem: nje Plan Veprimi per Teknologjite Mjedisore ne BE ". COM (2004) 38 final, i 28 Janarit 2004.

⁶ Komunikate per Keshillin e Pranveres "Te punojme sebashku per rritjen dhe krijimin e vendeve te reja te punes. Nje fillim i ri i Strategjise se Lisbones". COM (2005) 24, i 2 Shkurtit 2005.

⁷ "Nxitja e perdorimit te energjise nga burime te rinovueshme", COM (2008) 19 final, i 23 Janarit 2008

⁸ "Planin e Veprimit mbi Prodhimin dhe Konsumin e Qendrueshme dhe Politikes Industriale te Qendrueshme ", COM (2008) 397 final i 16 Korrikut 2008.

⁹ "Nje Inisiative Udheqese per Tregun European", COM (2007) 860 final, i 21 Dhjetorit 2007.

¹⁰

i Asistences per Harmonizimin Mjedisor e SME-ve (ECAP¹⁰), i cili synon te permiresoje performacen mjedisore te SME-ve.

Kjo Thirrje lidhet me CIP Aplikimet e para dhe projektet e ripërteritjes se tregut mbi Eco- Inovacionin, te cilat administrohen nga Agjencia Ekzekutive per Konkurrueshmerine dhe Novacionin (EACI), nen mandatimin e deleguar nga Komisioni European¹¹ .

Programi Kuader Eco-Innovation i Konkurrueshmerise dhe Novacionit perkufizohet si "Cdo forme novacioni qe synon progresin domethenes dhe te dukshem drejt qellimit te zhvillimit te qendrueshem, nepermjet reduktimit te ndikimeve mjedisore ose arritjes se nje perdorimi me eficient dhe te pergjegjshem te burimeve natyrore, perfshire energjine."¹²

CIP-Eco-Innovation synon te mbeshtese projekte qe lidhen me aplikimet e para dhe projektet e ripërteritjes se tregut te teknikave, produkteve, sherbimeve ose praktikave eco-innovative me perkatesi Komunitare, te cilat jane demonstruar tashme teknikisht me sukses por te cilat per shkak nje fare risku rezidual, nuk kane arritur ende te cajne tregjet. Keto duhet te kontribuojne ne eliminimin e pengesave per zhvillimin dhe aplikimin ne mase te Eco-Innovacionit, te krijojne apo zgjerojne tregjet per produkte qe lidhen me keto kategori, si dhe te permiresojne konkurrueshmerine e sipermarrjeve Europiane ne tregjet globale. Projektet duhet te synojne gjithashtu ne reduktimin e ndikimeve mjedisore, rritjen e eficenses se burimeve ose permiresimin e performances mjedisore te sipermarrjeve, ne vecanti te SME-ve.

Tre aspektet kryesore te CIP-Eco Innovation jane:

1. Perfitimet mjedisore
2. Perfitimet ekonomike (perfshire edhe ripërteritjen e gjere)
3. Kontributin novativ te projekteve

P.sh zbatimi i gjere i teknologjive dhe novacioneve miqesore ndaj mjedisit pritet qe te ndikojne ne reduktimin e emetimeve te gazit sere, te perdore me eficence me te larte burime si uji dhe lendet e para, te rrise sasine e materialeve te ricikluara, te prodhoje produkte cilesore qe shkaktojne me pak ndikim mbi mjedisin dhe te zbatoje procese dhe sherbime prodhimi, te cilat jane me miqesore ndaj mjedisit. Ndikimet mjedisore dhe optimizimi i burimeve duhet te konsiderohen ne menyre jo te izoluar pergjate gjithë kohezgjatjes se aktiviteteve perkatese: qe nga e nxjerrja e lendeve te para e deri tek prodhimi, shperndarja, perdorimi dhe administrimi i mbetjeve apo riciklimi duhet te behen me nje perqasje te plote **Life-Cycle**¹³.

¹⁰ "I vogel, I paster dhe Konkurues, Nje Program ne ndihme te SME-ve per te permbushur legjislacionin mjedisor", COM(2007) 379 final i 2 Tetorit 2007.

¹¹ Vendimi i komisionit i 31 Majit 2007 qe ndryshin Vendimin 2004/20/EC per trnasormimin e "Agjencise Ekzekutive te Energjise Inteligjente" ne "Agjencine Exekutive per Konkurrueshmerine dhe Novacionin" (OJ L 140/52 i 1 Qershorit 2007).

¹² Vendimi N° 1639/2006/EC i Parlamentit European dhe i Keshillit te 24 Tetorit 2006 te cilet krijojne Programin Kuader te Konkurrueshmerise dhe Novacionit (2007 deri 2013) (CIP) (OJ L 310, 09/11/2006). (Shiko Recital N°25).

¹³ Perqasja Life-Cycle lidhet me te gjitha ndikimet mjedisore ne menyre integrale. Kjo perqasje perfshin ciklin e plote nga nxjerrja deri tek prodhimi, transportimi, konsumi dhe ne fund administrimi i mbetjeve. Nje Vleresim i Ciklit te Jetes (Life-Cycle) mund te kryhet sipas versionit me te perdituesuar te International Reference Life Cycle Data System (ILCD) http://lca.jrc.ec.europa.eu/EPLCA/Deliverables/ILCD_handbook.htm.

Ne vazhdim Eco-Innovation duhet te kete kuptim ekonomik dhe duhet te sjelle perfitime te prekshme persa i perket investimeve, xhiro vjetore, penetrimi ne treg dhe krijimit te vendeve te punes ne menyre te vecante kur eshte fjala per SME-te. Aspekte te tjera te rendesishme pervec aplikimit te zgjidhjeve te reja ekoinovative gjate projektit jane edhe ripërteritja dhe shfrytezimi: CIP Eco-Innovation synon te shumefishoje ndikimet e zgjidhjeve qe ofrojne keto projekte si dhe te mobilizojte nje krijim te gjere te aksesit ne tregje, duke krijuar nje mase kritike gjate projektit ne afate te shkurtra dhe te mesme. Secili projekt duhet te permbaje nje plan te qarte biznesi dhe shfrytezimi.

Ekzistojne shume novacione teknologjike dhe tregtare, te cilat tashme jane testuar teknikisht dhe qe kane prodhuar perfitime domethenese per mjedisin. Sfida tanime eshte sigurimi i forcave te reja nxitese qe inkurajojne *Perhapjen dhe zbatimin e Ekoinovacionit ne nje shkalle te gjere, duke maksimizuar perfitimet e tij ekonomike dhe mjedisore*. CIP Eco-Innovation synon te mbushe boshllëkun ndermjet kerkimin shkencor, demonstrimit teknologjik dhe krijimit e modelit prototip nga njera ane dhe komercializimit te tyre nga ana tjetere. Ne qender te CIP Eco-Innovation eshte shfrytezimi dhe ripërteritja e zgjidhjeve ekoinovative, te cilat mund te kene vlere tregu. Novacioni dhe ne vecanti econovacioni eshte nje koncept progresiv. Ai mund te kete forma te ndryshme si p.sh. novacioni i proceseve apo teknologjive, novacioni i produkteve dhe sistemeve organizative dhe prezantimet e reja ne tregje.

Nepermjet perfitimeve mjedisore nivelit te novacionit ose potencialit te ripërteritjes se tregjeve projektet duhet te ofrojne nje interes europian, duke sjelle ne kete menyre nje kontribut domethenes ne rritjes se aksesit te ekonovacionit ne tregun e BE-se.

2. Qellimi dhe objektivat e Thirrjes per Propozime 2009

CIP Eco-Innovation do te mbeshtese projekte:

- Qe lidhen me aplikimin e pare ose ripërteritjen ne treg te teknikave, produkteve, proceseve ose praktikave ekoinovative qe:
- Jane demonstruar tashme teknikisht, por
- Per shkak te risqeve respective kane nevojte per incentiva per te care ne menyre te ndjeshme tregjet.

CIP Eco- Innovation do te mbeshtese gjithashtu aktivitetet te orientuara drejt tregut te cilat lidhen me futjen ne treg te teknologjive mjedisore dhe aktivitetet ekoinovative nga ana e sipermarrjeve si dhe implementimit te qasjeve te reja ose te integruara te Eco-Innovacion.

Projektet qe lidhen me administrimin dhe planifikimin e perdorimit te tokes, administrimin e zonave natyrore, politikave urbane dhe projektet me nje dimension publik duhen prezantuar ne Programin LIFE+¹⁴ dhe/ose tek Programi Kuader RTD i 7-te¹⁵. Projektet qe fokusohen tek rritja e penetrimit te energjive te rinovueshme dhe

¹⁴ Rregullorja (EC) No 614/2007 e Parlamentit European dhe e e Keshillit te 23 Majit 2007 lidhur me Instrumentin Financiar per Mjedisin (programi LIFE+): <http://ec.europa.eu/environment/life/index.htm>.

¹⁵ Zhvillimi i Teknologjise duhet te paraqitet tek tek Programi Kuader i 7-te per Kerkimin dhe Zhvillimin e Teknologjise (7 RTD): http://cordis.europa.eu/fp7/home_en.html.

te eficences energjitike, (perfshire energjine ne transport), duhet te prezantohen tek Programi i Europes me Energji Inteligjente¹⁶. Kerkimi dhe zhvillimi teknologjik, perfshire dhe projektet demonstrative ne nje faze te hershme me risk teknologjik te larte, ose projekte qe zhvillojne modele prototipe, duhen prezantuar tek Programi Kuader RTD i 7-te¹⁷. Ne synimin e tij te ripërteritjes se tregjeve CIP Eco-Innovation duhet te shkoje pertej shperndarjes, ekspozimit e trajnimit, dhe zhvillimit te software-ve, mjeteve dizenjuese ose komercializimit te paster te produkteve.

Objektivat

- Te nxise aplikimin e qasjeve te reja dhe te integruara te eco-novacionit ne fusha si administrimi mjedisor dhe produkte, procese dhe sherbime me miqesore karshi mjedisin.
- Te inkurajoje futjen ne treg te zgjidhjeve mjedisore, duke rritur qofte futjen e tyre ne treg apo heqjen e barrierave te penetrimit te tregjeve. Keto zgjidhje nenkuptojne perfshirjen e produkteve, proceseve, teknologjive apo sherbimeve.
- Te rrise kapacitetet novative te SME-ve.

Ne pergjithesi, kjo Thirrje mbeshet projektet, te cilat adresojne objektivat e siper permendura me nje prioritet te qarte karshi SME-ve. Gjithsesi, disa fusha marrin prioritet per kete Thirrje per shkak te rëndesise se tyre per mbrojtjen e mjedisit dhe tregjet ekonomike si dhe per shkak te pritshmerive per kontribut me vlere te shtuar te projekteve ne keto fusha, duke konsideruar veprime te tjera te Komunitetit ne fusha te ngjashme si dhe reagimet karshi Thirrjeve paraprirese. Keto fusha do te prezantohen ne vazhdim.

3. Fushat prioritare te Thirrjes per propozime 2009

3.1 Riciklimi i materialeve

Perpjekjet per te reduktuar dhe evituar ndikimet negative te mbetjeve ne mjedis dhe ne shendetin njerezor kane qene ne qender politikës mjedisore te BE-se. Megjithatë progresin e arritur sfidat per politikat e administrimit te mbetjeve vazhdojne te rriten dhe ka ende shume per te bere ne kete fushe.

“Strategjia Tematike mbi parandalimin dhe riciklimin e mbetjeve”¹⁸ e BE-se parashtron objektivat dhe mekanizmat nepermjet te cileve BE-ja mund te permiresoje me tej administrimin e mbetjeve dhe te perdore me mire burimet e saj materiale dhe

¹⁶ Europa me Energji Inteligjente perfshihet ne Programin Kuader per Konkurruesmerine dhe Novacionin (CIP) me Vendimin No 1639/2006/EC te Parlamentit Europian dhe Keshillit te 24 Tetorit 2006: http://ec.europa.eu/energy/intelligent/index_en.html.

¹⁷ Sipas vendimit te CIP, CIP “duhet te komplementoje Programin e Shtate Kuader te Komunitetit per kerkimin, zhvillimin teknologjik dhe aktivitetet demonstruese (2007-2013), duke konsideruar novacionin, I cili perfshin novacionin teknologjik dhe ate jo-teknologjik, qe kane kaluar pertej fazes demonstruese dhe qe jane gati per ripërteritjen ne treg (testimi i novacioneve per aplikimin ne tregje). Duhet te sigurohet qe nuk ka mangesira financimi ndermjet kerkimit, zhvillimit dhe aplikimit (aktivitetet e transferimit te teknologjive perfshi edhe fazes e para-modelimit)...” (Shiko Recital N°9).

¹⁸ Komunikata e Komisionit "Te cojme perpara perdorimit e qndrueshem te burimeve: Nje Strategji Tematike mbi parandalimin dhe riciklimin e mbetjeve”, COM (2005) 666 final, i 21 Dhjetorit 2005.

energjitike. Iniciativa e koheve te fundit LeadMarket per riciklimin specifikon nevojën per nxitjen e novacioneve tregtare ne fushen e riciklimit¹⁹. Direktiva e re e Kuadrit te Mbetjeve, parashtron hierarikine e mbetjeve e cilat duhet respektuar dhe percakton gjithashtu disa objektiva me ambicioze per riperdorimin, riciklimin dhe rekuperimin e disa kategorive te mbetjeve²⁰.

Novacioni mbulon nje game te gjere te procesesh, metodash, teknologjish dhe qasjesh te riciklimit dhe te riperdorimit, si p.sh: automatizimi, rradhitja, trajtimit, teknologjite e ndarjeve sikurse edhe novacionet tregtare qe lidhen me riciklimin riperdorimin.

Fushat e veprimeve qe do te mbeshteten nga kjo Thirrje:

- Procese dhe metoda me te mira te rradhitjes se mbetjeve materiale, mbetjeve te ndertimit, mbetjeve industriale/tregtare, mbetjeve te riciklueshme nga pajisje elektrike dhe elektronike si dhe automjeteve qe nuk dalim me ne qarkullim.
- Produkte novative qe perdorin materiale te ricikluara ose lehtesojne riciklimin e materialeve, ne perputhje me standartet e produkteve nderkombetare, kerkesat e avancuara te dizenjimit dhe nevojave konsumatore me cilesi te larte.
- Novacionet tregtare per forcimin e konkurruesmerise se industrive ricikluese si struktura te reja tregu per riciklimin e produkteve, rrjetet e ofruesve ose proceset dhe ndermarrjet e harmonizuara te riciklimit.

3.2 Ndertimet

Sektori i ndertimit eshte nje sektor kompleks qe perfshin nje sere aspektesh duke filluar nga dizenjimi, zgjedhja e materialeve, perdorimi i burimeve natyrore si dhe nderveprimi me nje sere kontekstesh socio-ekonomike rregullatore dhe administrative.

Novacioni manifestohet ne disa forma ose ne nivelin e produkteve ose ne nivelin e performances se ndertimeve apo te sherbimeve qe i ofrohen konsumatoreve/banoreve nga ana e rrjeteve ofruese²¹. Aspektet mjedisore potencialisht te prekshme nga novacioni perfshijne qendrueshmerine e materialeve, cilesine e ajrit te brendshem, eficencen e ujit dhe energjise apo adaptimin karshi ndryshimit klimaterik.

Kjo Thirrje per Propozim perfshin procese apo produkte novative si dhe sherbime ose qasje te integruara te ndertimit te sektoreve rezidenciale dhe jorezidenciale²², te cilet

¹⁹ "Nxitja e zhvillimit te tregut per riciklimin ne Europe." Dokument pergatitor per Komunikaten "Nje initiative Lead-Market per Europen", COM (2007) 860 final, i 21 Dhjetorit 2007:

http://ec.europa.eu/enterprise/leadmarket/doc/annex_1.pdf

²⁰ Direktiva 2008/98/EC e Parlamentit Europian dhe e Keshillit, 19 Nentor 2008 mbi Mbetjen dhe Ndryshimin e Disa Direktivave.

²¹ "Nxitja e tregut te ndertimeve me zhvillim te qendrueshem ne Europe" Dokument pergatitor per Komunikaten "Nje initiative Lead-Market per Europen", COM (2007) 860 final, i 21 Dhjetorit 2007::

http://ec.europa.eu/enterprise/leadmarket/doc/sustainableconstruction_final.pdf

²² Sektori i Infrastruktures eshte i perjashtuar.

ofrojne mundesi domethenese biznesi ne te gjithë fazat (ndertimi, mirembajtja, riparimi, meremetim ose shembjet e ndertesave).

Fushat e veprimeve qe mbeshteten nga kjo Thirrje:

- Produkte novative ndertimi qe synojne nje perdorim me racional te burimeve natyrore dhe nje ndikim mjedisor te reduktuar, perfshi proceset dhe materialet fabrikuese.
- Kjo do te perfshije, joekskluzivisht produkte te bera prej materialesh ndertimi jotoksike, te riperdorshme apo te ricikluara, elemente ndertimi qe bazohen ne burime te rinovueshme ose nga materiale nga burime lokale, materiale izoluese qe nuk permbajne HFC-(Hydro Fluoro Compounds) dhe VOC-(Volatile Organic Compounds), produkte ose materiale me konsum vetiak te ulet energjistik²³.
- Riperdorimi dhe riciklimi i mbetjeve te ndertimeve dhe te shembjeve, te cilat reduktojne dukshem nevojen per landfill-e dhe per nxjerrjen e mineraleve. Teknika novative, kost-eficente, selektive rradhitje te mbetjeve te ndertimeve dhe te shembjeve.
- Sisteme novative te ujit perfshire kursimin e ujit, riperdorimin e ujrave natyror, mbledhjes dhe riperdorimit te ujit te shiut, ose cative te gjelbra.

3.3 Sektori i ushqimit dhe pijeve

Sektori i ushqimeve dhe pijeve kontribuon maksimalisht me 20-30 % te ndikimeve te ndryshme mjedisore te konsumit privat si perdorimi i energjise, ngrohja globale, perdorimi i tokes, shterrimin e burimeve, acidifikimin, perdorimin e ujit ose mbetjeve, me nje kontribut deri ne 50% per eutrofikimin²⁴. Keto ndikime perfshijne rrjetet e prodhimit dhe shperndarjes se ushqimit ‘nga fermat tek piruni’.

Prioritet do t’i jepet atyre sektoreve te ushqimit dhe pijeve me ndikime te larta mjedisore, si mishit dhe produkteve te tij, te pasuara nga produktet e bulmetit dhe nga industri te tjera si prodhimi i ullinjve. Mishi dhe produktet e tij (perfshi pularine, salcicet apo te ngjashme) kane ndikimin me te larte mjedisor qe shkaktohet nga konsumi privat. Kontributi I ketij grupi produktesh ne ngrohjen globale vleresohet te jete nga 4-12% te te gjithë produkteve. Grupi i dyte i produkteve qe kane ndikim te rendesishem ne ngrohjen globale jane produktet e bulmetit.

Fushat e veprimeve qe do te mbeshteten nga kjo Thirrje:

- Produkte me te pastra dhe novative, pershi metodat e paketimit dhe materialet, proceset dhe sherbimet qe synojne nje eficence me te larte te burimeve. Perdorimi i plote i lendeve te para ne sektorin e ushqimit, i cili

²³ Energjia vetjake, me fjale te tjera energjia e nevojshme pergjate gjithë ciklit te jetes per ndertimin, produktet, materjalet apo sherbimet: fabrikimi, shperndarja, riciklimi/riperdorimi dhe mbetjet, duke perfshire te gjitha korburantet dhe transportin e perdorur gjate te gjitha fazave.

²⁴ Shiko rezultatet e studimit te EIPRO: Ndikimi Mjedisor i Produkteve (EIPRO). Analiza e ndikimeve mjedisore te ciklit te jetes qe lidhet me konsumin final te EU-25. Komisioni European, Qendra e Perbashket Kerkimore, projekti IPTS/ESTO, EUR 22284 EN, Maj 2006.

- rrit eficencen dhe efektivitetin e burimeve, redukton mbetjet e bio-degradueshme, dhe mbështet tranzicionin drejt një ekonomie bio.
- Produkte, procese dhe shërbime me të pastra dhe novative që synojnë reduktimin e mbetjeve dhe të emetimeve të gazrave sere, dhe/ose rrisin riciklimin dhe rekuperimin.
 - Eficence me e lartë në konsumin e ujit të një procesi ose eko-eficence e përmirësuar e administrimit të ujit.
 - Produkte procese dhe shërbime me të pastra dhe novative që synojnë reduktimin e impaktit mjedisor të konsumit të ushqimit dhe pijeve, si p.sh etiketimi apo shërbimet logjistike që lidhen me paketimin, shpërndarjen dhe shitblerjen.

3.4 Bizneset e gjelbra/ Blerjet inteligjente

Qëllimi i kësaj fushe prioritare është ofrimi i granteve në mbështetje të SME-ve dhe organizatave në “gjelberimin” e bizneseve, produkteve dhe shërbimeve si dhe në përmirësimin e administrimit të të gjithë aspekteve dhe ndikimeve mjedisore²⁵, dhe në adaptimin kundër ndikimeve të ndryshimit klimaterik në aktivitetet e tyre²⁶.

Gjelberimi i biznesit mund të marrë disa forma: prokurimi i gjelber dhe incentive kundër blerjes së pajisjeve dhe ofrimit të shërbimeve, prezantimi i qasjes lifecycle, në mënyrë që të konsiderohet nxjerrja e lendeve të para, prodhimi, konsumi dhe faza përfundimtare e jetegjatesisë së një produkti, integrimi i teknikave eko-novative dhe parimeve të eko-dezenjimit nga ana e rrjeteve ofruese etj. Aktoret e rendesishëm janë, sigurisht prodhuesit, të cilët duhen adresuar preferueshëm në grupe apo organizime sektoriale, dhe nga ana tjetër konsumatorët.

Në mënyrë që të përballë sfidat afatgjate të ndryshimeve klimaterike është e domosdoshme të behen adaptimet. SME-të mund të kenë me shumë veshtirësi sesa kompanitë e mëdha për t’u përballuar kundër risqeve dhe pasojave të ndryshimeve klimaterike. Gjithsesi, nga këto përballje mund të lindin mundësira të reja biznesi.

Fushat e veprimeve që do të mbështeten nga kjo Thirrje:

- Qasje novative ndaj EMAS (Skemat e Eko-manaxhimit dhe auditimit) përfshirë rritjen e efikasitetit të burimeve dhe të energjisë dhe aspekteve të biodiversitetit në grupe industriale apo distrikte SME-sh, duke përdorur qasje specifike kundër këtyre grupeve apo rrjeteve ofruese²⁷. Qasja sipas grupeve është e detyrueshme për këto prioritet. Këto qasje duhet të reduktojnë kostot e konsulentëve dhe të auditimit/verifikimit për pjesëmarrjen e SME-ve, dhe të lehtësojnë shkëmbimin e dijeve dhe të

²⁵ Sipas referimeve në Planin e Punes mbi Prodhimin dhe Konsumin e Qëndrueshëm dhe mbi Politikën Industriale të Qëndrueshme, COM (2008) 397 final, i 16 Korrikut 2008.

²⁶ Sipas Dokumentit të Bardhë mbi Adaptimin kundër ndryshimeve klimaterike: Drejt një kuadri evropian veprimesh, COM(2009) 147/4

²⁷ Rregullorja (EC) No 761/2001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 19 Marsit 2001 "Lejimi i pjesëmarrjes vullnetare nga ana e organizatave në skemën e Eko-administrimit dhe të auditimit (EMAS)"; OJ L 114, 24 Prill 2001, fq. 1-29, ende në rishikim.

eksperiencës ndërmjet pjesëmarrësve duke inkurajuar një politikë mjedisore koherente brenda grupit.

- Mbeshtetja dhe implementimi i produkteve dhe shërbimeve që do të ulin ndikimet mjedisore në vijim të parimeve të Politikës së Produkteve të Integruara²⁸ dhe në baze të qasjes Life-cycle²⁹ si edhe konform politikave të ndryshme të percaktuara në Planin e Veprimit mbi Konsumin dhe Prodhimin e Qëndrueshëm dhe Politiken Industriale të Qëndrueshme³⁰.
- Zbatimi dhe forçimi i përdorimit të kriterëve mjedisore (bazuar mbi Eco-Etiketimin evropian apo etiketa/certifikata të tjera të akredituara) për vendimarrjen e blerjeve në një sipërmarrje (p.sh. gjelberimin e rrjeteve ofruese, zbatimin e qasjeve novative të prokurimit) si dhe zbatimin me të gjere të konceptit të Prokurimi Publik i Gjelber³¹ (GPP) tek sektori privat.
- Gjelberimi i prodhimit, duke mbështetur procese novative mjedisore me një faktor të lartë ripërteritës.

4. Kriteret e pranueshmërisë

4.1 Statusi ligjor i aplikanteve

Aplikimet mund të paraqiten nga një ose disa entitete³². Te gjithë aplikantët duhet të jenë persona juridikë, private ose publike, të vendosur në territorin e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. “Person juridik” nënkupton cilindo entitet të krijuar sipas ligjit kombëtar ligjor të BE-së ose ligjit ndërkombëtar në vendodhjen e tij, i cili ka personalitet juridik dhe i cili mund të ushtroje të drejtat dhe detyrimet në emër të tij.

Entitetet të cilat nuk kanë personalitet juridik sipas ligjit kombëtar mund të propozojnë veprime brenda Iniciativës CIP Eco-Innovation, nëse përfaqësojnë i tyre kapacitet që të marrë përsipër detyrime ligjore dhe përgjegjësi financiare në emër të tyre.

Personat fizikë nuk janë të pranueshëm.

Gjithashtu programi është i hapur edhe për persona juridikë të vendosur në:

- Vendet e Organizatës Evropiane të Tregëtisë së Lire (EFTA), të cilët janë anëtarë të Hapësirës Ekonomike Evropiane (EEA), sipas kushteve të percaktuara në Marrëveshjen të EEA-së.

²⁸ Komunikatë nga Komisioni "Politikë e Integruar e Produkteve", COM (2003) 302 final, i 18 Qershorit 2003.

²⁹ Qasja Life-cycle do të përfshijë përdorimin e lendeve të para të ricikluar, rritjen e kohezgjatjes së produkteve nëpërmjet dizajnit të produkteve dhe shërbimeve, zbatimin e teknikave eko-eficiente për reduktimin e ndikimit mjedisor të prodhimit, minimizimin e ndikimeve mjedisore të produkteve gjatë përdorimit të tyre dhe sigurinë për reciklimin në fundin-e-jetes apo ripërdorimin.

³⁰ "Plani i Veprimit mbi Prodhimin dhe Konsumin e Qëndrueshëm dhe Politikën Industriale të Qëndrueshme", COM (2008) 397 final i 16 Korrikut 2008.

³¹ http://ec.europa.eu/environment/gpp/pdf/buying_green_handbook_en.pdf

³² Pavarësisht nga numri i pjesëmarrësve, të gjitha propozimet duhet të demonstronë një vlerë të shtuar Evropiane (shiko kriterin e 5).

- Vendet kandidat apo te asociuara, te cilet perfitojne nga nje strategji para-aderimi, ne perputhje me parimet e pergjithshme, termat dhe kushtet e pjesemarrjes se ketyre vendeve ne programet Komunitare sipas percaktimit te bere ne Marreveshjet Kuader respektive dhe ne Vendimet e Keshillit te Asocimit.
- Vendet e Ballkanit Perendimor sipas parashikimeve qe do te vendosen ne vijim te nenshkrimet te marreveshjeve kuader per pjesemarrjen ne Programet Komunitare.
- Vende te tjera te treta, kur e lejojne Marreveshjet apo procedurat.

Nese perzgjidhen propozime te prezantuara nga entitete ligjore qe i perkasin vendeve joanetare te BE-se sipas percaktimeve te mesiperme, marreveshja e grantit nenshkruhet vetem pasi keto vende kane ndermarre te gjithë hapat e nevojshem per anetaresimin ne EIP.

Informacion i perditesuar mbi listen e vendeve qe jane pjese e programit mund te gjendet ne faqen e internetit te Eco-Innovation³³.

Programi eshte gjithashtu i hapur per Qendren e Perbashket Kerkimore te Komisionit Europian dhe per organizata nderkombetare (p.sh entitete ligjore qe i perkasin nje organizate shtetesh, te ndryshme nga Bashkimi Europian te krijuara ne baze te nje traktati apo akti te ngjashem, te cilat kane institucione te perbashketa dhe nje personalitet juridik nderkombetar te ndryshem nga ai i vendeve te tyre anetare).

Aplikantet duhet te paraqisin evidenca qe vertetojne ekzistencen e tyre si persona juridike.

Kriteret e pranueshmerise do te verifikohen nga EACI-ja pas marrjes se nje propozimi. Mospermbushja e ketyre kriterëve do te rezultojne ne mosvleresimin e metejshem te propozimit.

5. Kriteret e perjashtimit

5.1 Arsyet per perjashtim

Aplikantet nuk do te konsiderohen per dhenien e nje granti nese aplikantet jane ne nje prej situatave te meposhtme:

- (a) kane falimentuar ose jane ne proces, po administrohen nga gjykata, kane hyre ne nje marreveshje me kreditore, kane pezulluar aktivitetet e tyre, jane subjekt i procedurave qe lidhen me te mesipermet apo jane ne cfaredo shtate analoge qe lind nga nje procedure e ngjashme sipas percaktimeve te bera ne legjislacionin apo rregulloret kombetare.
- (b) jane denuar per nje shkelje qe lidhet me sjelljen profesionale me ane te nje gjykimi qe ka forcen e res judicata.
- (c) jane konsideruar fajtores per shkak te nje sjelljeje te rende joprofesionale qe mund te provohet me ane te cfaredo lloj mjeti nga ana e autoritetit kontraktues.

³³ http://ec.europa.eu/environment/etap/ecoinnovation/index_en.htm.

- (d) nuk kane permbushur detyrimet lidhur me pagesat e kontributeve te sigurimeve shoqerore apo pagesat e taksave konform parashikimeve ligjore te vendit ne te cilin jane vendosur apo me ato te vendit te autoritetit kontraktues apo me ato te vendit ku do te zbatohet kontrata.
- (e) ka qene subjekt i nje gjykimi i cili ka forcen res judicata per shkelje, mashtrim, korrupsion, perfshirje ne nje organizate kriminale apo cfaredo aktiviteti tjeter ilegal, i cili demton interesat financiare te Komuniteteve.
- (f) jane aktualisht subjekt i nje penaliteti administrativ sipas nenit 96 (1) te Rregullores Financiare te zbatueshme per buxhetin e pergjithshem te Komuniteteve³⁴.
- (g) perballen me nje konflikt interesi
- (h) jane fajtores per keqperfaqesimin ne ofrimin e informacionit te kerkuar nga autoriteti kontraktues si nje kusht per pjesemarrjen ne procedure apo kane deshtuar te ofrojne kete informacion.

Aplikantet duhet te dorezojne evidence qe nuk jane ne asnje prej situatave te sipermendura. Per kete arsye, aplikantet duhet te dorezojne nje vetedeklarim si pjese e dosjes se aplikimit³⁵.

5.2 Penalitetet administrative dhe financiare

Pa ndikuar ne zbatimin e penaliteve te specifikuara ne kontrate kandidatet dhe kontraktoret te cilet kane bere deklarata false, kane bere gabime esenciale apo kane shkaktuar parregullsi apo mashtrim, apo jane shpallur ne thyerje serioze te detyrimeve te tyre kontraktore mund te perjashtohen nga te gjitha kontratat te financuara nga buxheti i Komunitetit per nje periudhe kohore maksimale prej 5 vjetesh qe prej dates ne te cilen eshte kryer shkelja sipas nje procedure ne kundërshtim me kontraktorin. Kjo periudhe mund te shtyhet ne 10 vjet nese verehet riperteritja e shkeljes brenda 5 viteve nga data ne te cilen eshte evidentuar shkelja e pare.

Kandidatet, te cilet kane bere deklarata false, kane bere gabime esenciale, apo kane kryer parregullsi ose mashtrim, mund te jene gjithashtu subjekt i penaliteve financiare qe perfshijne shumat prej 2 deri ne 10 % te vleres totale te kontrates se akorduar. Kontraktoret qe kapen ne shkelje serioze te detyrimeve te tyre kontraktore mund te jene subjekt i penaliteve financiare qe perfshijne shumat prej 2 deri ne 10 % te vleres totale te kontrates ne fjale. Kjo norme mund te rritet ne 4-20% ne rastet e riperteritjes se shkeljes brenda nje periudhe kohore prej 5 vjetesh qe prej dates ne te cilen eshte kryer shkelja sipas nje procedure ne kundërshtim me kontraktorin.

Rastet e referuara ne piken 5.1 (e) perfshijne:

- (a) Rastet e mashtrimit sipas percaktimit te nenit 1 te Konventes mbi mbrojtjen e interesave te Komuniteteve Europiane, te miratuar me Aktin te Keshillit te 26 korrikut 1995³⁶.

³⁴ Rregullorja e Keshillit (EC, EURATOM) n.1605/2002 e 25 Qershorit 2002 mbi Rregullat Financiare qe zbatohen per buxhetin e pergjithshem te Komuniteteve Europeane (OJ L 357 3 1 Dhjetor 2002) sipas ndryshimeve te bera me Rregulloren e Keshillit (EC, EURATOM) 1995/2006 e 13 Dhjetorit 2006 (OJ L 390/2006 e 30 Dhjetorit 2006).

³⁵ Format e Aplikimit do te jene te vlefshme ne websitin e Eco-Innovation.

- (b) Rastet e korrupsionit sipas percaktimit te nenit 3 te Konventes te luftes kunder korrupsionit qe perfshin zyrtare te Komuniteteve Europiane apo zyrtare te Shteteve Anetare te BE-se, miratuar me Aktin te Keshillit te 26 maj 1997³⁷.
- (c) Rastet e perfshirjes ne nje organizate kriminale sipas percaktimit ne nenin 2 (1) te Veprimit te Perbashket 98/783/JHA te Keshillit³⁸.
- (d) Rastet e pastrimit te parave sipas percaktimit ne nenin 1 te Direktives te Keshillit 91/308/EEC³⁹.

6. Kriteret e perzgjedhjes

Aplikuesi duhet te kete burime te mjaftueshme dhe te qendrueshme financimi per te mbajtur aktivitetin e tij gjate periudhes ne te cilen veprimi po kryhet dhe te kontribuojne ne financimin e tij. Aplikanti duhet te kete aftesite profesionale dhe kualifikimet (teknike dhe administrative) e nevojshme per permbushjen e veprimit te propozuar si dhe kapacitetin per administrimin e nje aktiviteti te permasave te ketij veprimi.

6.1 Kapaciteti financiar i aplikanteve

Aplikantet duhet te tregojne qe kane kapacitetin financiar dhe operativ per te permbushur veprimin qe do te mbeshtetet. Me perjashtim te rasteve kur ato jane nje institucion publikose nje organizate nderkombetare ata duhet te plotesojne 'Deklaraten Financiare te Thjeshtezuar' si dhe te dorezojne deklaratat financiare vjetore te tyre qe duhet te permbajne bilancin, llogarite e fitimit dhe te humbjes dhe cfaredo aneksi te tyre per vitin e fundit financiar per te cilin jane mbyllur kontabiliteti.

6.2 Aftesite profesionale dhe kualifikimet

Aplikantet duhet te kene kapacitetet teknike dhe profesionale si dhe aftesine operative dhe administrative per te permbushur veprimin e propozuar dhe duhet te ofrojne dokumente ne mbeshtetje te tyre (p.sh pershkrimin e ekspertizes se personave pergjegjes per zbatimin e veprimit me nje reference te qarte te pergjegjesive te tyre ne projekt, pershkrimin e projekteve dhe aktiviteteve qe lidhen me veprimin e ndermarre gjate 3 viteve te fundit etj).

Kriteret e perzgjedhjes do te vleresohen si nje hap i pare nga komiteti vleresues. Mospermbushja e ketyre kriterëve do te rezultojne ne mosvleresimin e metejshem te propozimit nga ana e komitetit vleresues. Aplikanteve mund t'u kerkohet te sigurojne prova shtese apo te qartesoje dokumentet mbeshtetese qe lidhen me kriteret e perzgjedhjes.

³⁶ OJ C 316 e 27 Nentorit 1995, fq. 48.

³⁷ OJ C 195 e 25 Qershorit 1997, fq. 1.

³⁸ OJ C 351 e 29 Dhjetorit 1998, fq.1. Veprimi i perbashket i 21 Dhjetorit 1998 mbi percaktimin si veprim kriminal pjesemarrjen ne nje organizate kriminale ne Vendet Anetare te Bashkimit Europian.

³⁹ OJ L 166 e 28 Qershorit 1991, fq. 77. Direktiva e 10 Qershorit 1991, sipas ndryshimeve me Direktiven 2001/97/EC ote Parlamentit Europian dhe te Keshillit te 4 Dhjetorit 2001 (OJ L 344 e 28 Dhjetorit 2001, fq. 76).

7. Kriteret kryesore te shpalljes se fituesit

Agjencia Ekzekutive per Konkurruesmerine dhe Novacionin do te bazoje selektimin e veprimeve dhe normen e bashkefinancimit te Komunitetit mbi propozimet e shkruara. Veprimet do te vleresohen sipas 5 kriterëve, te cilet do te jene peshe te barabarte ne vleresimin e pergjithshem. Gjithsesi nje note prej te pakten 7 (nga 10) do te nevojitet per kriterin e pare dhe nje note prej te pakten 6 (nga 10) per kriteret e tjera. Gjithashtu totali i notave per te gjitha kriteret duhet te jete me i madh ose i barabarte me 34 (nga 50). Propozimet qe i kalojne te tere keto kufi do te konsiderohen per financim. Komiteti vleresues do te beje nje klasifikim rendites, i cili do te miratohet nga zyrtari i autorizuar. Grantet do te akordohen brenda kufinjve te burimeve buxhetore ne dispozicion.

Kriteret e meposhtme te shpalljes se fituesit do te zbatohen per projekt propozimet:

1. Relevanca e veprimeve te propozuara sipas objektivave te percaktuara ne Thirrje (rezultati nga 0 deri ne 10, kufiri minimal 7): novacioni dhe mjedisi.

Ky kriter i shpalljes fitues synon te perzgjedhe veprimet qe jane me relevante dhe qe mbeshtesin me mire objektivat dhe prioritetet e siperpermendura te politikave. Ai perfshin nje vleresim te karakterit novativ te projektit dhe te perfitimeve te tij mjedisore. Ai permban nenkriteret e meposhtme:

- Rendesia e veprimit ne lidhje me politikat, prioritetet, qellimet dhe legjislacionin e BE-se si dhe ne lidhje me kete Thirrje per Propozime.
- Masen e novacionit qe permbajne zgjidhjet e propozuara.
- Avancimin teknik te zgjidhjeve te propozuara, qartazi pertej fazes se modelit prototip.
- Perfitime te qarta dhe thelbesore mjedisore perfshire eficencen e burimeve dhe pershtatshmerine e synimeve dhe te indikatorëve te performances.
- Konsiderimi dhe adresimi i qarte i grupit te synuar te SME-ve.

2. Cilesia e veprimeve te propozuara (rezultati nga 0 deri ne 10, kufiri minimal 6):

Ky kriter synon te vleresoje saktesine dhe koherencen e projektit nga nje kendveshtrim teknik dhe i administrimit te projektit dhe lidhur me metodologjine e perzgjedhur. Permban nenkriteret e meposhtme:

- Struktura, qartesia, konsistenca dhe qendrueshmeria e qasjes se propozuar (perkufizimi i paketave, orarit dhe produkteve te punes) per te arritur rezultatet e pritshme.
- Perberja, balanca e aftesive dhe pergjegjesive e ekipit dhe anetareve te tij.
- Administrimi, perfshire dhe strukturen e administrimit te projektit, planin e punes, koordinimin dhe komunikimet e ekipit te projektit.

3. Ndikimi mbi audiençen e synuar, ripërteritja dhe ndikimi ne treg (rezultati nga 0 deri ne 10, kufiri minimal 6):

Ky kriter synon te perzgjedhe veprimet me nje faktor te larte ripërteritje te afte per te krijuar apo zgjeruar tregjet. Projekt propozimet duhet te ofrojne nje vleresim te qarte dhe realist te tregut per zgjidhjet eko-novative. Permban nenkriteret e meposhtme:

- Faktorin ripërterites te zgjidhjes (i cili mund te aplikohet nga kompani te tjera dhe ne vende te tjera), qe realizohet gjate projektit dhe potencialin e tij per ripërteritje afatshkurter dhe afatmesme.
- Pershtatshmeria e vleresimit te tregut dhe e qasjes per heqjen e barrierave te evidentuara te tregut perballe zgjidhjes eko-novative.
- Cilesia e shfrytezimit te planifikuar dhe qasja e tij tregtare.

4. Buxheti dhe kost-efektiviteti (rezultati nga 0 deri ne 10, kufiri minimal 6):

Ky kriter do te ndihmoje ne perzgjedhjen e projekteve me kosto te arsyeshme te mire justifikuara permban nenkriteret e meposhtme:

- Nivel te pershtatshme perpjekjesh (ore dhe buxhet) si per paketen e punes dhe ndermjet partnereve duke marre ne konsiderate aftesite dhe pergjegjesite e tyre respektive.
- Peshe te pershtatshme te kostove per secilen kategori, vecanerisht per pajisjet (perfshire justifikimin e pajisjeve ne lidhje me veprimin novativ).
- Koherenca dhe transparenca e skemes se bashkefinancimit.

5. Vlere te shtuar europiane (rezultati nga 0 deri ne 10, kufiri minimal 6):

Ky kriter do te ndihmoje ne perzgjedhjen e projekteve me nje vlere te shtuar europiane. Permban nenkriteret e meposhtme:

- Justifikimi dhe perfitimi i adresimit te thelbit te propozimit ne nivel europian per karshi nderhyrjes ne nivel kombetar/rajonal/lokal.
- Dimensioni European i barrierave te tregut dhe si do te eliminohen keto barriera.
- Niveli i bashkepunimit europian ne kete projekt.

8. KOHEZGJATJA

Kohezgjatja maksimale e nje veprimi eshte 36 muaj.

9. PERQINDJA E BASHKEFINANCIMIT KOMUNITAR

Kontributi financiar ne CIP Eco-Innovation merr formen e nje granti qe synon kompensimin pjesor te kosto totale te pranueshme te projektit, nen nje nivel maksimal prej 50% te projektit.

Vetem kostot qe lidhen ne menyre direkte me veprime novative, duke perfshire materialet, proceset, teknikat apo metodat e propozuara, konsiderohen si te pranueshme. Kjo aplikohet gjithashtu per kostot e pajisjeve dhe infrastruktures.

Kontributi i Komunitetit per te rimbursuar kostot e pranueshme nuk duhet te rezultoje ne rritje te fitimit gjate kohezgjatjes se projektit. Kontributet ne natyre nuk konsiderohen kosto te pranueshme.

Nje veprim qe perfiton mbeshtetje financiare per te njejtit shkak nga instrumente te tjera financiare te Komunitetit nuk do te perfitoje financim nga kjo Thirrje per Propozime te Aplikimeve te Para dhe Projekte te Ripërteritjes se Tregut.

10. BUXHETI NE DISPOZICION PER KETE THIRRJE TE VITIT 2009

Shuma totale indikative e gatshme per kete Thirrje eshte 30 milion Euro.

11. Periudha e pranueshmerise se kostove

Si rregull i pergjithshem, kostot e pranueshme konsiderohen ato qe shpenzohen vetem pas firmosjes se marreveshjes se grantit nga te gjitha palet. Asnje grant nuk mund te akordohet ne menyre prapavepruese per aksione tashme te perfunduara.

12. KUSHTET E PERGJITHSHME PER AKORDIMIN E GRANTEVE

Kushtet e pergjithshme per te akorduar grantet, sidomos perkufizimi i kostove te pranueshme dhe metodat e pageses, jane te detajuara ne modelin e nje marreveshjeje granti, e disponueshme ne websitin e Eco-Innovation⁴⁰. Buxheti per Veprimin bashkengjitur aplikimit duhet te kete te ardhurat dhe shpenzimet ne bilanc dhe te tregoje qartesisht kostot qe jane te pranueshme per financimin nga ana e Komunitetit.

Ne baze te vleresimit te risqeve te saj, Agjencia Ekzekutive per Konkurrueshmerine dhe Novacionin duhet te kerkoje nje garanci financiare per parafinancim.

Nese aplikanti i sukseshem eshte nje organizate nderkombetare, modeli i Marreveshjes se Kontributit me nje organizate nderkombetare ose cdo tip kontrate tjeter e rene dakort mes organizates nderkombetare ne fjale dhe Autoritetit Kontraktues do te perdoret ne vend te nje teksti te bazuar ne modelin e marreveshjes se grantit.

⁴⁰ <http://ec.europa.eu/ecoinnovation>

13. FORMAT E DOREZIMIT TE APLIKIMEVE PER NJE GRANT

Aplikimet duhet te dorezohen duke perdorur sistemin e dorezimit on-line dhe formatet e aplikimit. Udhezimet per menyren e plotesimit te formateve te aplikimit dhe linku per sistemin e dorezimit online se bashku me formatet e aplikimit jane te gatshme ne websitin e Iniciatives CIP Eco-Innovation (shiko kapitullin 14 “Informacionet shtese”).

Aplikimet qe nuk arrijne te plotesojne kerkesat formale nuk do te vleresohen me tej.

Afati perfundimtar per dorezimin eshte 10 Shtatori 2009 perpara ores 17.00 (ora lokale e Brukselit).

Aplikimet e dorezuara pas dates se mbylljes nuk do te merren ne konsiderate.

Aplikantet keshillohen te mos presin oret e fundit per te dorezuar propozimet e tyre ne menyre qe te evitojne riskun e nje dorezimi te deshtuar per shkak te problemeve te paparashikuara (p.sh. shpejtesia e ulet e internetit). Çdo problem teknik i parashtruar nga aplikantet qe nuk i atribuohet direkt EPSS-se/Agjencise nuk do te merret ne konsiderate.

Draft versionet e propozimeve mund te dorezohen tashme edhe ne nje faze te hershme te pergatitjes – kordinatorët mund t’i zevendesojne me versione te perditesuar sa here qe te jete e nevojshme deri ne daten e mbylljes, duke zevendesuar keshtu draftet e meparshme.

Te qenit i regjistruar ne sistem dhe ngarkimi (upload) i dokumenteve ne sistem, ne rast se ende nuk keni kompletuar nje sere hapash te kerkuar per dorezimin aktiv nuk eshte e mjaftueshme per finalizimin e dorezimit.

Ne rast se do te kete ndryshime ne lidhje me kerkesat formale per dorezimin e aplikimeve, ato do te vihen ne dukje ne websitin e programit. Keshtuqë aplikantët keshillohen qe te kontrollojne kete web perpara dorezimit te aplikimeve te tyre.

14. INFORMACIONE SHTESE

Aplikantet duhet te konsultojne websitin e programit tek: <http://ec.europa.eu/ecoinnovation>

Websiti permban te gjithe informacionet dhe formatet ne lidhje me kete Thirrje per Propozime, sikurse edhe guiden e propozuesve, modelin e marreveshjes se grantit per t’u perdorur ne sistemin e dorezimit online. Gjithashtu, websiti informon ne lidhje me ditet e informimit qe do te mbahen gjate kohezgjatjes se Thirrjes per Propozim.

Çdo pyetje ne lidhje me kete Thirrje per Propozim duhet te dergohet tek Agjencia Ekzekutive per Konkurrueshmerine dhe Novacionin duke perdorur formatin e

kerkimit te dhenave qe gjendje online tek ky link:
http://ec.europa.eu/environment/etap/ecoinnovation/contact_en.htm

15. KALENDAR INDIKATIV:

Data e mbylljes per dorezimin e aplikimeve:	10 Shtator 2009 (perpara ores 17.00, ora lokale e Brukselit)
Data e parashikuar per kompletimin e vleresimit:	Janar 2010
Data e parashikuar per lajmerimin e aplikanteve:	nga Shkurti 2010 e me tej
Periudha e parashikuar per negociata	Shkurt/ Mars 2010
Data e parashikuar per firmosjen e kontratave	nga Marsi 2010 e me tej